



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 01.07.2013

Nr. 0208-742

Për: **Fadil Gashi**, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Klinës
Ali Shala, Zyra Ligjore dhe e Përfaqësimit

Lënda: Përgjigje në shkresë

Të nderuar

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar kërkesën lidhur me mundësinë e nxjerrjes së një rregullore për pagesën e ish zyrtarëve të lartë të Komunës së Klinës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Rregulloren nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të hollësishëm të legjislacionit, ka *konstatuar* se:

- Kuvendi i Komunës nuk ka mandat ligjor të nxjerrë rregullore, për pagesën e zyrtarëve të lartë të nivelit lokal të zgjedhur apo emëruar pas përfundimit të mandatit të tyre, për faktin se nuk është parapa me legjislacionin e zbatueshëm.
- Në programin Legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2013 është paraparë hartimi i Projektligjit për pagesën e të zgjedhurve të lartë publikë dhe të emëruarve publik, duke përfshirë edhe të zgjedhurit dhe të emëruarit publik në komuna.

MAPL, është e përkushtuar të ofrojë përkrahje dhe ndihmën e nevojshme, për zbatimin e plotë të këtyre obligimeve ligjore që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës.

Me respekt,
Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër & Ministër i MAPL-së

Kopje: Sokol Bashota, Kryetar i Komunës së Klinës
Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 01.07.2013

Br. 0208-742

Za : **Fadil Gashi**, Predsedavajući Skupštine Opštine Klina
Ali Shala, Pravna kancelaria i Predstavljnja

Predmet: Odgovro na dopisu

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave je primilo zahtev u vezi sa donošenjem jedne uredbe za plaćanje bivših viših službenika Opštine Klina .

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave na osnovu nadležnosti i odgovornosti određene po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, Uredbom br. 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti Kabineta Premijera i Ministarstva, posle detaljnog razmatranja zakonodavstva je *konstatovalo*:

- Skupština Opštine nema mandat da donse Uredbe, za isplatu viših službenika na lokalnom nivou izabranih ili imenovanih posle završetka njihovog mandata, jer to nije predviđeno prema sprovodljivom zakonodavstvu.
- U zakonodavnom programu Vlade Republike Kosovo za 2013 je predviđena izrada Nacrta zakona za isplatu visoko javno izabranih i javno imenovanih, uključujući javno izbarane i imenovane u opštinama.

MALS, je opredeljeno da ponudi podršku i potrebnu pomoć za potpuno sprovođenje ovih zakonskih obavaza koje proizilaze od spovodjeivog zakonodavstva za lokalnu samoupravu u Republiku Kosovo.

S poštovanjem,
Slobodan Petrović,
Zamanikpremijera & Ministar MALS-a

Kopija: Sokol Bashota, Gradonačelnik Opštine Klina
Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodiocima uprava
Arhivu MALS-a



PËR: Departamentit Ligjor të MAPL-së Drejtori z. Agron Magjuni, Prishtinë;
Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, sekretarin permanent Prishtinë

NGA: Komuna e Klinës, Zyra Ligjore dhe e Perfaqesimit, z. Ali Shala
z. Driton Raci



LËNDA: Kërkesë, për sqarim ligjor lidhur me mundësin e nxjerrjes së rregullores për
komunale për pagesën e ish zyrtareve të lartë të Komunës,

Kërkojmë nga titulli i juaj i lartëshënuar që në afatin sa më të shkurtër të na ofroj ndihmen
perkatëse juridike dhe sqarimin perkatës në drejtim të asaj se a ka mundësi dhe a egziston baza
ligjore për hartimin e projekt rregullores komunale për kompenzimin e pageses për ish zyrtarët e
lartë të komunës.

Një rregullore të tillë e ka të miratuar me sa kemi njohuri vërtet komuna e Gjilanit.
Ju lutemi që të na kthehni pergjegje sa me parë për faktin se edhe në komunën tonë është shfaq
kerkesa nga ana e kryetarit të Kuvendit të Komunës dhe stafit tjetër politik për një rregullore të
tillë.

Ju jemi shumë mirënjohës që paraprakisht të na sqaroni këtë çështje kjo edhe për faktin se si
Ministri dhe organ i shkallës së dytë keni pergjegjesinë e mbikqyrjes ligjore të akteve nonligjore
juridike të çdo komune në nivel vendi.

Meqëse rështia është urgjente shpresojmë të kemi basur në mirëkuptim dhe presim
pergjegje në afatin sa më të shkurtër në menyrë se kjo çështje të sqarohet para aktimit të secanses se
muajit qershor 2012.

Shtojcë: Rregulloria për Kompenzim të pageses për ish zyrtaret e lartë të Komunës së Gjilanit
Regullorja nr.01-16-17186 e dt. 15.07.2011.


Me respekt,

01Nr. 112-2616/2013
Klinë, dt.04.06.2013

HYRJESE-ULAZNA-INCOMING			
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarsvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration			
Data Datum Date		10.06.2013	
Nr. i Organizatës	Nr. i Lendës	Shtojca	Vlera
-11-	008-792	1	



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republike of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gjiçan Belediyesi

RREGULLORE
PËR
KOMPENSIM TË PAGËS PËR ISH
ZYRTATARËT E LARTË TË KOMUNËS

Në pajtim me nenin 12.2 pika c) dhe d) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me datën 15.07.2011, miraton:

R R E G U L L O R E N

PËR KOMPENSIM TË PAGËS PËR ISH ZYRTARËT E LARTË TË KOMUNËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore rregullohet kompensimi i pagës për ish zyrtarët e lartë të Komunës së Gjilanit, pas skadimit të mandatit, të cilët mbesin pa u sistemuar në vendet përkatëse të punës për shkak të rrethanave të parapara me këtë rregullore.

Neni 2

Zyrtar të lartë komunal në kuptim të kësaj rregulloreje konsiderohen: Kryetari i Komunës, Nënkyetari i Komunës, Kryesuesi, Zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe drejtoret e drejtorive të Komunës.

II. DISPOZITAT E VEQANTA

Neni 3

1. E drejta e kompensimit të pagës zyrtarëve të lartë komunal nga neni 2 i kësaj rregullore u takon në rastet në vijim:

- 1.1. nëse pas skadimit të mandatit për të cilin janë zgjedhur ose emëruar nuk janë sistemuar në ndonjë vend pune;
- 1.2. nëse gjatë ushtrimit të mandatit të zyrtarëve të lartë komunal për shkak të paaftësisë së tij shëndetësore nuk është në gjendje që në mënyrë të përhershme ta ushtroj funksionin e tij;
- 1.3. nëse gjatë ushtrimit të mandatit, zyrtari i lartë komunal vdes, e që familja tij nuk ka burime financiare.

Neni 4

1. E drejta e kompensimit të pagës për ish zyrtarët e lartë të komunës dhe ish anëtar të kuvendit të Komunës u takon që nga data e përfundimit të mandatit në funksionin në të cilin janë zgjedhur ose emëruar e deri në sistemin e tyre në ndonjë vend të punës, e jo më gjatë se katër vite.
2. E drejta e kompensimit për ish zyrtarët e lartë të komunës për shkak të paaftësisë së tyre objektive për ta ushtruar funksionin fillon nga dita e paraqitjes së paaftësisë së tyre, e vlen deri në fillimin e realizimit të hyrave financiare nga ndonjë burim tjetër, e jo më gjatë se një vit.

Neni 5

1. E drejta në kompensimin e pagës prej 70% të pagës bazë i takon ish Kryetari të Komunës, Nënkyetarit të Komunës, Kryesuesit dhe Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës.
2. E drejta në kompensimin e pagës prej 70% të pagës bazë me kompensim i takon ish anëtarit të Kuvendit të Komunës.

Neni 6

Mjetet financiare për kompensim e pagës sigurohen nga buxheti i Komunës.

Neni 7

1. Ish zynari i lartë i Komunës, mund të heqë dorë nga drejta e realizimit të kompensimit të pagës.
2. Të drejtën e kompensimit nuk e gëzojnë zyrtarët sipas nenit 2 të kësaj rregulloreje të cilët nuk kanë ushtruar funksionin në të cilin janë zgjedhur ose emëruar në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.

III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 8

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje do të jenë në fuqi për derisa nuk nxirret ndonjë ligj apo akt tjetër nënligjor që rregullon këtë çështje.
2. Për zbatimin e kësaj rregullore, Komuna parasheh mjete me projekt – buxhetet për vitet vijuese.

Neni 9

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Gjilanit dhe fillon të zbatohet prej 1 janarit të vitit 2012.

01. Nr. 5/17876
Gjilan, më 15.07.2011

Kuvendi i Komunës,

Izmi Zeka, Kryesues